



Panel Diskutimi

“Anketimi Kombëtar 2014 mbi Perceptimet dhe Pritshmëritë drejt Anëtarësimit të Mundshëm të Shqipërisë në BE”

27 mars 2015, EU Info Center

Rr. “Ismail Qemali”, Nr. 32, Tiranë

Nga muaji qershor 2014, Shqipëria është zyrtarisht vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Përmirësimi i perceptimit të përbashkët mbi Bashkimin Evropian (BE) dhe një kuptim më i gjerë mbi institucionet, vlerat dhe procedurat e saj është një projekt mjaft i rëndësishëm dhe afatgjatë. Pjesa dërrmuese e popullsisë shqiptare vazhdon ta mbështesë fuqimisht integrimin evropian. Autoritetet shqiptare dhe BE-ja kanë punuar së bashku për të adresuar këto çështje. Ka patur progres në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të audiencën shqiptare mbi BE-në.

Gjatë muajve maj-tetor 2014, Delegacioni i BE në Shqipëri angazhoi Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë/Soros të ndërmerre “Anketimin kombëtar 2014 mbi perceptimet dhe pritshmëritë drejt anëtarësimit të Shqipërisë në BE”. Studimi ofron informacion të detajuar mbi nivelin e dijes dhe të kuptuarit të qytetarëve shqiptarë mbi BE-në, nivelin e dijes dhe të kuptuarit rreth punës së BE-së dhe çfarë nënkupton procesi i integrit. Studimi hedh dritë mbi kanalet e informacionit më të përdorura nga qytetarët kur kërkojnë informacione mbi BE-në dhe integrimin evropian dhe shpjegon faktorët që ndikojnë në formimin e opinionit shqiptar rreth çështjeve të BE. Gjithashtu ky studim analizon këto faktorë duke ofruar rekomandime se si mund të përmirësohet strategjia e komunikimit e BE-së.

Rezultatet e anketimit të Shqipërisë janë shumë interesante pasi paraqiten të krahasuara me rezultatet e vendeve të tjera evropiane duke përdorur rezultatet e pesë Eurobarometrave standartë; më specifikisht Eurobarometeri 76.1 (2011), Eurobarometeri 77.4 (2012), Eurobarometeri 79.1 (2013), Eurobarometeri 79.2 (2013) and Eurobarometeri 80.1 (2013).



Programi

10.50 h	Regjistrimi
Mirëseardhja dhe fjalët përshëndetëse	
11.00 h	<ul style="list-style-type: none">• Andi Dobrush, Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë• Ambasadorja Romana Vlahutin, Kreu i Delegacionit European të Shqipërisë• Klajda Gjosh, Ministre, Ministria e Integritimit European
11.30 h	<ul style="list-style-type: none">• Klodjan Seferaj, Menaxher Programi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë• Komete dhe pyetje nga pjesëmarrësit
12:30 h	Koktejl